



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT DIBËR

RAPORT

I

VEPRIMTARISË SË ADMINISTRATËS SË PREFEKTIT PËR VITIN 2022

Veprimtaria e përditshme një vjeçare e Institucionit të Prefektit të Qarkut Dibër, ka konsistuar në ndërtimin e një marrëdhënieje të bashkëpunimit reciprok, si me Institucionet Qëndrore në Nivel Vendor ashtu edhe me Organet e Vetëqeverisjes Vendore, duke bashkërenduar gjithashtu veprimtaritë e tyre, me qëllim realizimin e objektivave qeverisëse, ruajtjen e rendit dhe sigurisë në qark, rritjen e cilësisë së shërbimit ndaj publikut, parandalimin dhe menaxhimin e emergjencave civile, rritjen e nivelit të sigurisë ushqimore, rritjen e nivelit të sigurisë në rrugë, ofrimin e shërbimeve arsimore dhe shëndetësore cilësore, kontrollin e territorit dhe monitorimin e çdo lloj veprimtarie ligjore të institucioneve në qark.

Në kuadër të zbatimit të Ligjit nr. 107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, detyrimeve që rrjedhin prej tij dhe rregullores së brendshme të institucionit, veprimtaria e përditshme e administratës së Prefektit ushtrohet sipas ndarjes së detyrave për çdo sektor si dhe të funksionimit të organizmave të përhershëm ose të posaçëm të krijuara në mbështetje të punës së Prefektit.

Në vijim, me qëllim analizimin e punës së bërë në drejtim të përmbushjes së detyrimeve ligjore dhe koordinimit të punës për garantimin e zbatimit të ligjit në vendimmarrjen e NJVV-ve, për zgjidhjen e problemeve të përbashkëta ndërinstitutionale, menaxhimin e emergjencave civile dhe krizave etj., do të jepet një pasqyrë e detajuar me informacion:

Për vitin 2022 Institucioni i Prefektit të Qarkut Dibër, nëpërmjet bashkëpunimit ndërsektorial ka realizuar përgjithësisht këto detyra:

- Kontrollin e zbatimit të ligjit në vendimmarrjen e Njësive të Vetëqeverisjes Vendore, përgatitjen për çdo rast të shprehjes së Prefektit dhe ushtrimin e kontrollit në vend të praktikave shkresore që pasqyrojnë procesin e vendimmarrjes.
Në këtë kuadër, gjatë vitit 2022 janë shqyrtuar 438 (katërqind e tridhjetë e tetë) akte, ndërsa 426 (katërqind e njëzetë e gjashtë) prej tyre janë konfirmuar dhe 12 (dymbëdhjetë) janë kthyer për rishqyrtim. Nga aktet e kthyer për rishqyrtim 10 (dhjetë) janë konfirmuar

pas rregullimeve të kryera sipas rekomandimeve të Prefektit, ndërsa 2 (dy) akte janë anuluar sipas kërkesës së tij.

Përsa i përket kontrollit në vend të praktikave shkresore që pasqyrojnë procesin e vendimmarrjes janë verifikuar 396 (treqind e nëntëdhjetë e gjashtë) akte administrative të bashkive Dibër, Bulqizë, Mat dhe Klos.

- Garantimin e një bashkëpunimi ndërmjet institucioneve qendrore në nivel vendor dhe Njësive të Vetëqeverisjes Vendore me qëllim diskutimin, trajtimin dhe gjetjen e zgjidhjeve për probleme të përbashkëta.
- Prefekti ka koordinuar veprimtarinë e institucioneve të ndryshme në qark në raste kur janë shfaqur emergjenca civile për shkaqe natyrore ose të tjera.
- Trajtimin deri në zgjidhje të kërkesë-ankesave të qytetarëve dhe orientimin e tyre sipas rastit dhe nevojës.
- Koordinimin e punës së Organeve të Vetëqeverisjes Vendore dhe Institucioneve Qendrore në Nivel Vendor për realizimin në çdo kohë të kontrollit e përgjithshëm të territorit.

Gjatë vitit 2022 Prefekti i Qarkut Dibër, duke u bazuar në dispozitat e Ligjit nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, si dhe udhëzimeve të ardhura sipas rastit dhe nevojës nga dikasteret përkatëse, ka lëshur 44 (dyzetë e katër) urdhëra me anë të së cilave ka urdhëruar ngritjen e grupeve ndër-institucionale të punës për menaxhimin e problematikave të ndryshme, komisioneve shumëpalëshe për menaxhimin e situatave emergjente dhe ngarkimin me detyra të përkoshme të punonjësve të institucionit që drejton me qëllim realizimin e procesit ligjor të blerjeve për nevoja të institucionit, dorëzimit në arkiv të dokumentacionit, inventarizim etj..

Prefekti gjithashtu gjatë vitit 2022 ka marrë 9 (nëntë) vendime për “Emërim në Detyrë”, “Lirim nga detyra” dhe përfundim të procedurës për kthimin tek drejtuesi të lejeve të drejtimit të konfiskuara nga Drejtoria Vendore e Policisë Dibër.

Monitorimi i veprimtarisë së degëve territoriale:

Në zbatim të dispozitave të Ligjit 107/2016 “Për prefektin e Qarkut”, nën drejtimin e Prefektit janë organizuar dhe realizuar mbledhje mujore me Drejtues të Institucioneve Qendrore në Nivel Vendor, ndërsa për çdo rast janë kryer raportimet mbi realizimin e detyrave mujore sipas institucioneve dhe janë dhënë udhëzime nga Prefekti mbi realizimin dhe implementimin e politikave të qeverisë në qark.

Raportimi:

Në zbatim të dispozitave të Ligjit nr. 107/2016 “Për Prefektin e Qarkut” dhe detyrimeve që rrjedhin prej tij, Prefekti ka raportuar për Këshillin e Ministrave dhe Ministrinë e Brendshme, mbi aktivitetin e institucionit që drejton dhe mbi realizimin e detyrave nga institucionet qendrore në nivel vendor, duke përfshirë edhe informacion mbi kërkesat dhe ankesat e qytetarëve, evidencat e akteve, evidencat e realizimit të të ardhurave nga NJVV-të, realizimin e planit të të

ardhurave nga institucionet që realizojnë të ardhura, evidencat mbi realizimin e investimeve dhe problematika të lidhura me garantimin e rendit dhe të sigurisë publike etj.

Gjatë vitit, Prefekti gjithashtu ka monitoruar zbatimin dhe implementimin e politikave të qeverisë në qark si dhe procesin e realizimit të investimeve prioritare të qeverisë.

Prefekti, sipas rastit, ka raportuar nevojën për ndërhyrje dhe investime në rrugë, shëndetësi, arsim, rrjet vaditës, ujësjellësa si dhe për rehabilitimin e pasojave të fatkeqësive natyrore të rregjistruara në Qarkun Dibër gjatë vitit 2022.

Gjatë vitit 2022 janë kryer raportimet 6-mujore dhe raportimi vjetor i punës dhe veprimtarisë së degëve territoriale pas analizave të punës së kryera nga ana e tyre.

Në zbatim të përcaktimeve dhe kërkesave të Ligjit nr. 107/2016 “Për Prefektin e Qarkut” pranë Prefektit kanë funksionuar disa organizma rajonale siç janë:

Organi Këshillues pranë Prefektit:

Në kuadër të funksionimit të tij janë planifikuar dhe realizuar çdo muaj takime sipas një tematike të miratuar nga anëtarët e këtij organi.

Për vitin 2022 anëtarët e Organit Këshillues, nën drejtimin e Prefektit, kanë trajtuar dhe kanë rënë dakord për zgjidhje të përbashkëta mbi këto çështje:

1. Përcaktimin e prioritetëve për zhvillimin ekonomiko-shoqëror të Qarkut Dibër.
2. Diskutimin e planit të masave dhe analizimin e punës së bërë nga Drejtoria Rajonale e Rrugëve dhe Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore për mirëmbajtjen dhe rehabilitimin e infrastrukturës rrugore.
3. Diskutimin e planit të masave dhe analizimin e punës së Njësive të Vetëqeverisjes Vendore për pastrimin e territorit dhe menaxhimin e mbetjeve urbane.
4. Diskutim mbi mënyrat e zhvillimit të turizmit të qëndrueshëm në qark dhe hartimin e planit të përbashkët të masave për menaxhimin e sezonit turistik veror 2022.
5. Analizë e treguesve të planit të grumbullimit të taksave nacionale dhe vendore.
6. Diskutim i masave të marra dhe punës së bërë për furnizimin e popullatës me ujë të pijshëm dhe rritjen e nivelit të arkëtimit nga pagesat e konsumatorëve.
7. Diskutimi i masave të marra dhe zbatimi i tyre për eliminimin e punës informale.
8. Diskutim i masave të marra dhe punës së bërë për përmirësimin e sinjalistikës rrugore
9. Diskutim i masave të marra për përballimin e nevojave gjatë sezonit të ujitjes.
10. Diskutim i masave të marra për përgatitjen e ambjenteve shkollore për fillimin e vitit të ri shkollor 2022-2023.
11. Mbi prioritetet e investimeve në qark për përballimin e situatave emergjente etj.

Në varësi të problemeve dhe çështjeve të trajtuara në mbledhjet e Organit Këshillues, sipas rastit, janë thirrur për të dhënë mendimet e tyre edhe drejtues e specialistë të institucioneve qëndrore në nivel vendor dhe të NJVV-ve. Për çdo rast është përgatitur materiali shkresor i nevojshëm dhe informacioni që duhet dërguar në Ministrinë e Brendshme dhe Kryeministri.

Komisioni i Emergjencave Civile: Pranë Institucionit të Prefektit të Qarkut Dibër funksionon dhe ushtron veprimtarinë e tij në bazë të një plan-veprimi të hartuar paraprakisht Komisioni i Emergjencave Civile dhe Krizës.

Gjatë vitit 2022 nën drejtimin e Prefektit janë organizuar dhe janë realizuar dy mbledhje të planifikuara dhe dy të pa planifikuara të këtij komisioni me qëllim diskutimin e masave parandaluese dhe menaxhimit të situatave emergjente sipas rastit.

Në kuadër të menaxhimit të emergjencave civile, gjatë vitit 2022, në zbatim të detyrimeve të përcaktuara në Ligjin nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, Ligjin nr. 45/2019, “Për Mbrojtjen Civile” dhe në bazë të detyrave të përcaktuara në planin vjetor të punës së institucionit, është monitoruar situata në qark dhe është marrë informacion për çdo rast duke koordinuar në bashkëpunim me Qendrën Operacionale të Mbrojtjes veprimet e nevojshme për menaxhimin e ngjarjeve dhe situatave.

Institucioni i Prefektit nëpërmjet specialistëve të Sektorit të Emergjencave Civile ka koordinuar punën për menaxhimin e disa situatave emergjente nëpërmjet garantimit të një bashkëpunimi dhe angazhimi të përbashkët të institucioneve anëtare të Komisionit të Emergjencave Civile.

Raportohet se gjatë sezonit veror 2022, u regjistruan 50 (pesëdhjetë) vatra zjarri në pyje e kullota për shuarjen e të cilave si rezultat i bashkëpunimit ndërinstitutional, u angazhuan 48 (dyzetë e tetë) mjete zjarrfikëse dhe 2 (dy) mjete të bashkive, 256 (dyqind e pesëdhjetë e gjashtë) efektivë të MZSH-ve sipas bashkive përkatëse, 29 (njëzetë e nëntë) specialistë të pyjeve, 251 (dyqind e pesëdhjetë e një) punonjës të bashkive, 395 (treqind e nëntëdhjetë e pesë) forca vullnetare, 8 (tetë) punonjës të zonave të mbrojtura, si dhe 124 (njëqind e njëzetë e katër) efektivë të Forcve të Armatosura.

Institucioni i Prefektit nëpërmjet Sektorit të Emergjencave Civile ka koordinuar gjithashtu punën për menaxhimin e rasteve të rrëshqitjes së dheut si pasojë e rreshjeve të shiut dhe të dëborës dhe ka monitoruar vazhdimisht sipas nevojës punën e NJVV-ve dhe firmave kontraktore për pastrimin dhe hapjen e rrugëve të bllokuara nga dëbora.

Gjatë vitit 2022 është kërkuar informacion mbi sigurinë e digave dhe argjinaturave të lumenjve, ndërsa pritet financim për rehabilitimin e digës së ujëmbledhësit Shtjefën të Njesisë Administrative Derjan të Bashkisë Mat.

Raportohet se për vitin 2022, Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore kanë dëmshtëpërblyer 266 (dyqind e gjashtëdhjetë e gjashtë) familje në shumën 25 666 000 lekë për banesat e dëmtuara nga shkaqe natyrore (kryesisht tërmete):

- Bashkia Dibër: 8 709 000 lekë për 17 banesa.
- Bashkia Mat: 3 678 000 lekë për 13 banesa.
- Bashkia Klos: 832 000 lekë për 285 banesa.
- Bashkia Bulqizë: 12 447 000 lekë për 108 banesa.

Ndërsa nga Ministria e Mbrojtjes janë dëmtshpërblyer 314 familje me shumën 19 892 000 lekë sipas bashkive: Bashkia Dibër: 4 banesa me vlerë 1 434 000 lekë, Bashkia Klos 310 banesa me vlerë 18 458 000 lekë.

Gjatë vitit 2022 në Qarkun Dibër janë dëmtuar nga zjarri 15 (pesëmbëdhjetë) banesa për të cilat janë hartuar dhe miratuar në këshillat bashkiakë përkatës dosjet për përfitimin e dëmtshpërblimit ekonomik sipas ligjit. Sektori i Emergjencave Civile pranë Institucionit të Prefektit në bashkëpunim me sektorët e emergjencave civile pranë bashkive kanë furnizuar me materiale për strehim të përkohshëm nga Rezervat e Shtetit të gjitha këto familje të dëmtuara.

Në këtë kuadër gjatë vitit 2022, Institucioni i Prefektit ka kërkuar nga Drejtoria e Rezervave Materiale të Shtetit ndihma ushqimore për 2026 familje banesat e të cilave u dëmtuan nga faktorë natyrorë.

Për vitin 2022, Institucioni i Prefektit, nëpërmjet Sektorit të Emergjencave Civile, ka dërguar me qëllim përfitimin e dëmtshpërblimit financiar nga AKMC-ja 390 dosje të familjeve për bashkitë Dibër, Mat. Bulqizë dhe Klos.

Komiteti Rajonal i Luftës Kundër Trafikimit të Personave dhe Tryeza Teknike Rajonale Kundër Trafikimit:

Në mbështetje të këtyre organizmave funksionojnë gjithashtu pranë Nën/Prefekturave edhe nënkomitetet të cilat veprojnë sipas planit rajonal të hartuar në përputhje me Planin Kombëtar të Veprimit për Luftën Kundër Trafikimit.

Në zbatim të Ligjit nr. 107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, Urdhërit Nr. 6 datë 26. 01. 2017 të Kryeministrit, “Për Krijimin e Komitetit Rajonal të Luftës kundër Trafikimit të Personave në çdo Qark”, përveç 4 (katër) mbledhjeve të planifikuara, janë kryer edhe 4 (katër) takime të pa planifikuara në datat:

- 1. 02. 2022: u zhvillua në ambjentet e Institucionit të Prefektit takimi i organizuar nga Ministria e Brendshme në lidhje me mënyrat e parandalimit të migracionit të paligjshëm drejt Bashkimit Evropian.
- 19. 07. 2022: në ambjentet e Institucionit të Prefektit të Qarkut Dibër, nën drejtimin e Ministrisë së Brendshme në bashkëpunim me prezencën e UNICEF-it në Shqipëri, u zhvillua një takim me anëtarët e Komitetit Rajonal Antitrafik me qëllim adresimin, reagimin dhe parandalimin e trafikimit të qënieve njerëzore.
- 20. 09. 2022: Ministria e Brendshme në bashkëpunim me Organizatën Ndërkombëtare për Migracionin (IOM) në kuadër të Përmirësimit të Koordinimit të Qeverisjes së Migracionit në Shqipëri, zhvilluan pranë Institucionit të Prefektit sesionin informues mbi qeverisjen e migracionit në nivel rajonal.
- 06. 12. 2022: Ministria e Brendshme në bashkëpunim me UNICEF Albania zhvilloi në ambjentet e Institucionit të Prefektit një takim me anëtarët e komitetit rajonal antitrafik me qëllim koordinimin e punës së institucioneve në drejtim të parandalimit të trafikimit të personave dhe shmangies së rrethanave ndihmuese për këtë aktivitet të paligjshëm.

Për vitin 2022, si efekt i punës së organizmave që funksionojnë pranë Prefektit dhe garantimit të një angazhimi ndërinstitucional, janë menaxhuar 14 raste në Bashkinë Dibër, 96 raste (64 fëmijë dhe 32 viktima dhune në familje) në Bashkinë Mat, 23 raste në Bashkinë Bulqizë dhe 7 raste në Bashkinë Klos. Për secilin rast është dërgur informacion i detajuar pranë instancave përkatëse.

Grupi i Ekspertëve për Sigurinë në Rrugë: funksionon në bazë të urdhërit nr. 29, datë 26. 07. 2017 gjatë vitit 2022 janë zhvilluar 4 (katër) mbledhje ndërsa janë përgatitur nga Sektori i Monitorimit të Kompetencave Vendore 4 (katër) raporte.

Si rezultat i punës së përbashkët është përmirësuar sinjalistika rrugore dhe është shtuar vëmendja për mirëmbajtjen e rrugëve dhe orientimin e qarkullimit në rrugë.

Si problem i trajtuar vazhdimisht në takimet e grupit mbeten problematikat në aksin rrugor Ulëz-Klos si dhe në segmetin Ura e Çerenecit-Maqellarë pjesë e rrugës së “Arbërit”.

Komiteti Rajonal i Zhvillimit të Turizmit: Nën drejtimin e Prefektit funksionon Komiteti Rajonal i Zhvillimit të Turizmit i cili është mbledhur rregullisht dhe ka trajtuar problemet e turizmit në qark. Informojmë se gjatë vitit vizituan Qarkun Dibër 135.000 turistë vizitorë vendas e të huaj, ndërsa në vitin 2021 ishin 87.000.

Në mbështetje të Ligjit nr. 93/2015 “Për Turizmin” e në zbatim të Udhëzimit nr. 8502, datë 24.10.2016 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komitetit Rajonal të Zhvillimit të Turizmit” nën drejtimin e Prefektit ka funksionur dhe ka zhvilluar disa mbledhje Komiteti Rajonal i Zhvillimit të Turizmit rezultatet e punës së të cilit i janë drejtuar në rrugë shkresore ministrisë përkatëse.

Në zbatim të Urdhërit nr.83 datë 11.05.2022 të Kryeministrit, “Për ngritjen e Task Forcës Ndërinstitucionale të Sezonit Turistik Veror 2022”, Prefekti i Qarkut Dibër hartoi urdhërin e brendshëm nr.17, datë 21.06.2022 “Për ngritjen e Task Forcës Ndërinstitucionale të Sezonit Turistik Veror 2022 për Qarkun e Dibrës” e cila ka vepruar për të realizuar kërkesat e qeverisë për mbarëvajtjen e sezonit turistik veror.

Sipas Zyrave të Informacionit Turistik në Qarkun Dibër, nga analiza e rrjedhës së vizitorve strategjik rezulton se: Qarku Dibër është vizituar nga rreth 60 000 vizitorë vendas e të huaj. Nga këto 85% janë vizitorë vendas dhe 15% janë të huaj.

Komiteti i Menaxhimit të Zonave të Mbrojtura:

Në përmbushje të detyrimeve që rrjedhin nga përcaktimet në VKM- në nr. 593/2018 “Për përbërjen, funksionimin, detyrat e përgjegjësitë e Komitetit të Menaxhimit të Zonave të Mbrojtura Mjedisore” janë zhvilluar nën drejtimin e Prefektit dy takime me drejtues të AdZM-së. Në këtë kuadër përfaqësues të institucionit kanë marrë pjesë në takimet e Komitetit të Menaxhimit të Zonave të Mbrojtura Mjedisore të zhvilluar në ambientet e Institucionit të Prefektit të Qarkut Kukës, të KMZMM-së për zonat e përbashkëta me Qarkun e Elbasanit dhe të KMZMM-së për zonat e përbashkëta me Qarkun e Tiranës.

Gjthashtu në përgjigje të shkresës së ardhur nga Drejtoria e Menaxhimit të Pyjeve në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, është kërkuar informacion për masat e marra për zgjidhjen e problemeve ndërkufitare të ekonomive pyjore të bashkive pasi ka patur mosmarrëveshje për kufijtë e ekonomive pyjore.

Situata Mjedisore dhe bujqësia: Prefekti me qëllim monitorimin e zbatimit të urdhërave dhe udhëzimeve të qeverisë në fushën e kontrollit të territorit, mbrojtjen e mjedisit, mbrojtjen e lumenjve nga shfrytëzimi pa kriter i shtretërve të tyre, mbrojtjen e pyjeve dhe parandalimin e ndërtimeve të paligjshme, ka realizuar disa takime me kryetarët e bashkive, përfaqësues IKMT-ve dhe me përfaqësues të Drejtorisë Vendore të Policisë Dibër.

Në kuadër të monitorimit të menaxhimit të këtyre çështjeve, përfaqësues të Institucionit kanë marrë pjesë në dëgjuesën publike të zhvilluar me grupet e interesit në Bashkinë Dibër lidhur me propozimin për rishikimin e Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Dibër.

Ndërsa në zbatim të detyrimeve të ligjit nr. 91/2013 “Për vlerësimin strategjik mjedisor”, për shprehjen e qëndrimit mbi nevojën ose jo të realizimit të këtij procesi, institucioni është përfaqësuar gjithashtu në takimet e zhvilluara pranë Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit me grupet e interesit lidhur me propozimin konkret për rishikimin e Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkive Dibër dhe Kukës.

Gjatë vitit 2022 janë ndjekur edhe problematikat që lidhen me menaxhimin e mbetjeve urbane dhe pastrimin e territorit. Duke e trajtuar këtë problem si prioritet të qeverisë, Prefekti ka organizuar takime me kryetarët e bashkive, ndërsa ka kërkuar rritjen e masës së buxhetit për trajtimin e mbetjeve dhe përmirësimin rrënjësor të situatës së pastrimit në qark. Synimi për vitin 2023 është shtrirja e shërbimit të pastrimit dhe tërheqjes së mbetjeve urbane në të gjithë territorin e qarkut. Bashkitë e qarkut kanë hartuar për këtë qëllim, plane javore, mujore dhe vjetore, për realizimin e të cilave raportohet në vijimësi.

Një prioritet tjetër i qeverisë, zbatimi i së cilit është ndjekur nga Prefekti lidhet me riorganizimin e drejtorive të UK-ve me qëllim përmirësimin e shërbimit dhe të gjendjes së tyre financiare.

Prefekti së bashku me specialistë të institucionit ka qenë i angazhuar për koordinimin e punës së institucioneve të posaçme me qëllim marrjen dhe aplikimin e masave për parandalimin e përhapjes së sëmundjes së shpendëve. Lidhur me menaxhimin e kësaj problematike janë zhvilluar takime pune me përfaqësues të Drejtorisë Vendore të Policisë Dibër dhe Përgjegjësin e Sektorit Veterinar dhe Mbrojtjes së Bimëve Dibër.

Gjithashtu në zbatim të VKM-së nr. 206 datë 30.07.2021, *"Për bashkëpunimin e NJVV-ve me Shërbimin Veterinar"*, janë zhvilluar takime me drejtues të bashkive dhe Sektorit të Shërbimit Veterinar të Qarkut me qëllim koordinimin e aksionit të formalizimit të tregjeve të tregëtimit të kafshëve të gjalla dhe sigurimin e kushteve sipas standarteve që kërkohen.

Prefekti gjithashtu është angazhuar dhe ka zhvilluar takim me Drejtorin e Drejtorisë Rajonale të Mbrojtjes së Bimëve duke diskutuar dhe kërkuar zgjidhje për caktimin sipas rregullave të

vendgroposjes së kafshëve të ngordhura, liçensimin e tregjeve të gjësë së gjallë, kontrollin e thertoreve dhe shitjen e mishit sipas standarteve.

Shërbimet online:

Institucioni i Prefektit të Qarkut Dibër, duke u bazuar në përmbajtje të projekt-vendimit të Këshillit të Ministrave u angazhua për të informuar sipas udhëzimeve të gjithë qytetarët se nga data 01.05.2022 do të kenë mundësi të marrin nëpërmjet portalit “e-albania” 95 % të shërbimeve që deri atëherë i kanë marrë nëpërmjet sporteleve fizike.

Në këtë kuadër, Prefekti ka realizuar disa takime pranë Njësive të Vetëqeverisjes Vendore me qëllim këshillimin e punonjësve të zyrave të Gjendjes Civile për orientimin e qytetarëve mbi mënyrën e re të marrjes së shërbimeve të kërkuara.

Shëndetësi e Covid-19:

Institucioni i Prefektit të Qarkut Dibër, ka monitoruar dhe kërkuar herë pas here informacion mbi ecurinë e procesit të vaksinimit të popullatës me vaksinën anti-covid. Gjatë vitit 2022 raportohet të jenë vaksinuar 116.227 persona.

Po kështu janë ndjekur nga ana e institucionit të Prefektit investimet e kryera në sektorin e shëndetësisë si dhe janë raportuar të gjitha problematikat në lidhje me infrastrukturën e qendrave shëndetësore dhe mungesën e mjekëve dhe infermierëve në spitalin rajonal apo disa qendra shëndetësore.

Konkretisht raportohet se Qendra Shëndetësore e Njesisë Administrative Kala e Dodës të Bashkisë Dibër është jashtë funksionit si pasojë e dëmtimeve infrastrukturore ndërsa shërbimi ofrohet në mënyra alternative për banorët e interesuar. Raportohet se mungojnë 8 (tetë) mjekë familjeje dhe 18 (tetëmbëdhjetë) infermierë.

Gjatë muajit tetor 2022 në kuadër të ndërgjegjësimit të grave për rëndësinë e parandalimit të kancerit të gjirit janë kryer disa aktivitete ndërsa pranë spitalit rajonal janë kryer gjithsej 1840 mamografi nga të cilat 85 raste janë referuar për kontroll të specializuar në Tiranë.

Realizimi të ardhurave dhe investimet nga NJVV-të:

Për vitin 2022, sipas informacioneve të marra nga Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore masa e realizimit të të ardhura sipas bashkive është: Bashkia Dibër - 84%, Bashkia Mat - 87%, Bashkia Bulqizë - 116 %, Bashkia Klos – 76 %, ndërsa në shkallë qarku masa e realizimit të të ardhurave raportohet të jetë në masën 91 %.

Përsa i përket realizimit të investimeve nga bashkitë masa e realizimit është: Bashkia Dibër- 65.68%, Bashkia Bulqizë 93.68%, Bashkia Klos- 61.97% dhe Bashkia Mat 60.87 %.

Ankesat e shtetasve: gjatë vitit 2022 janë trajtuar nga specialistë të institucionit 120 kërkesë- ankesa të ardhura në adresë të Prefektit, ndërsa janë pritur dhe sqaruar sipas kërkesës së tyre 220 qytetarë. Problematikat që përgjithësisht shqetësojnë qytetarët lidhen me: pronën, servitutet e kalimit, trajtimin me ndihmë ekonomike, punësimin, Emergjencat Civile, HEC-et, guroret etj.

Janë trajtuar 100% e kërkesë-ankesave duke dhënë zgjidhje ose orientim sipas rastit. Në drejtim të Prefektit nuk është regjistruar asnjë ankesë në Portalin e Bashkëqeverisjes.

Zgjedhjet vendore jashtë radhe për kryetar të bashkisë Dibër 6 mars 2022:

Institucioni i Prefektit ka ndjekur dhe monitoruar zbatimin e udhëzimeve për mirëfunksionimin e procesit zgjedhor, duke filluar që nga shpallja e listave të zgjedhësve për Bashkinë Dibër. Është raportuar pranë KQZ-së mbi ecurinë e procesit. Gjithashtu janë marrë masa për të vënë në dijeni të gjitha institucionet për domosdoshmërinë e mospërfshirjes së administratës në fushatën zgjedhore ndërsa është kryer raportimi për këtë qëllim pranë DAP-it dhe Komisionerit për Nënpunësin Civil.

Mbledhje e takime të paplanifikuara gjatë vitit 2022:

Nën drejtimin e Prefektit, gjatë vitit 2022, janë kryer 17 (shtatëmbëdhjetë) mbledhje e takime pune për trajtimin e çështjeve të ndryshme si:

- Takime me qëllim dhënien e asistencës juridike për mirëfunksionimin e Njësive të Vetëqeverisjes Vendore në drejtimet e mëposhtme: Miratimin e Rregullores Tip, për organizimin dhe funksionimin e Këshillave të Bashkisë, nëpërmjet së cilës saktësohen procedurat që duhet të ndiqen nga këto organe, për nxjerrjen e akteve administrative me propozim të organit ekzekutiv, me inisiativë të NJQV-ve apo me kërkesë të subjekteve të ndryshme të së drejtës për interesa publike.
- 4 (katër) trajnime e mbledhje me temë emigracionin e paligjshëm dhe luftën kundër trafikimit të personave të organizuara nga Ministria e Brendshme në bashkëpunim me prezencën e IOM-it e UNICEF-it në Shqipëri.
- Mbledhje me Drejtorinë Vendore të Policisë së Shtetit dhe institucione të tjera për masat e marra dhe zbatimin e tyre në funksion të luftës kundër kultivimit të bimëve narkotike.
- Mbledhje me institucionet përkatëse për menaxhimin e situatës së krijuar nga gripi i shpendëve.
- Janë zhvilluar dy takime me Njësitë e Vetë Qeverisjes Vendore me qëllim prezantimin e nismës për ofrimin online të 95% të shërbimeve për qytetarët.
- Mbledhje e Task-Forcës për turizmin veror me kërkesë të Ministrisë së Turizmit.
- Me kërkesë të Ministrisë së Mbrojtjes është zhvilluar një mbledhje me strukturat e Emergjencave Civile në qark me qëllim koordinimin e punës për parandalimin e zjarreve në pyje e kullota.
- Takim i përbashkët i Ministrisë së Mbrojtjes, Ministrisë së Brendshme dhe Ambasadës Amerikane me qëllim diskutimin e mënyrave për zhvillimin e kapaciteteve të MZSH-ve.
- Në kuadër të bashkëpunimit me Ambasadën Zvicerane nëpërmjet projektit “Bashki të Forta” u zhvillua një takim i përbashkët me qëllim diskutimin e sfidave që kanë organet e vetëqeverisjes vendore në ushtrimin e autoritetit dhe kompetencave të tyre.
- Me kërkesë të Komisionerit për të Drejtën e Informimit është zhvilluar një mbledhje e përbashkët me anëtarët e nënkomiteteve për luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore.

Objektivat për vitin 2023:

Si konkluzion final, Prefekti theksoi se qëllimi kryesor i punës për vitin 2022 do të konsistojnë në angazhimin për realizimin e këtyre objektivave:

- Institucioni i Prefektit do të nxisë, nëpërmjet shembullit personal, rritjen e angazhimit të të gjithë institucioneve për të ofruar shërbime cilësore ndaj publikut.
- Institucioni i Prefektit, nëpërmjet ushtrimit të rolit të tij koordinues, do të angazhohet maksimalisht për realizimin me sukses të projekteve prioritare të Qeverisë Shqiptare sipas rastit.
- Institucioni i Prefektit do të angazhohet maksimalisht për të realizuar një bashkëpunim ndërinstitutional dhe koordinim të punës së bashkive për të realizuar objektivin e Qeverisë për mirëmenaxhimin e mbetjeve, shmangien e krijimit të vendgrumbullimeve të paligjshme dhe shtrirjen e shërbimit të pastrimit dhe largimit të mbetjeve në të gjithë territorin e Qarkut Dibër.
- Institucioni i Prefektit, në fokus të punës së tij, do të ketë ndjekjen dhe monitorimin e procesit të mirëmenaxhimit të ndërmarrjeve të UK-ve dhe rrjedhimisht të procesit të furnizimit me ujë të popullatës.
- Institucioni i Prefektit, në fokus të punës së tij do të ketë menaxhimin e Emergjencave Civile nëpërmjet parandalimit të ngjarjeve duke nxitur bashkitë për të parashikuar fonde, përmirësuar strukturat, dhe duke garantuar bashkëpunim me operatorët privatë të kontraktuar nga bashkitë sipas parashikimeve ligjore.
- Kontrolli i territorit dhe mbrojtja e mjedisit mbetet prioritet i punës së administratës së Prefektit, i cili do të realizohet duke bashkërenduar më mirë punën kontrolluese në terren të policisë, IKMT- së dhe Bashkive në kuadër edhe të mirëfunksionimit të Komitetit të Menaxhimit të Zonave të mbrojtura Mjedisore.

Si konkluzion, çmujmë se analiza e veprimtarisë së Institucionit të Prefektit të Qarkut Dibër për vitin 2022, për mënyrën se si u trajtuan çështjet i'a arriti plotësisht qëllimit, duke nxjerrë në pah punën dhe rolin e Prefektit për ushtrimin e përgjegjësiave të tij, mënyrën e ndërtimit të marrëdhënieve me institucionet qendrore e vendore, si dhe vendosjen e objektivave për vitin 2023.

PREFEKTI

NEXHBEDIN SHEHU

